



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
MINISTRIA E DREJTËSISË

Tiranë, më 14.10.2020

Lënda: Minutat e takimit të katërt konsultativ të draft Planit të Veprimit të OGP, komponenti i IV “Qeverisje e Hapur në Luftën kundër Korrupsionit” objektivit specifik “Planet e Integritetit”, dt. 14.10.2020.

I mbajtur sot, më dt. 14.10.2020, Online sipas Platformës Webex¹, takimi i katërt konsultativ i draft Planit të Veprimit të OGP, komponenti i IV “Qeverisje e Hapur në Luftën kundër Korrupsionit” me objektivit specifik “*Planet e Integritetit*” midis Ministrisë së Drejtësisë, përfaqësuesve të Kryeministrisë, ekspertes C. McLaren, OGP si dhe Organizatave të Shoqërisë Civile.

Në këtë takim, fjalën përshëndetëse e merr znj. Pregja e cila bëri një përshkrim të shkurtër të procesit të OGP lidhur me planin e veprimit për objektivin specifik “*Planet e integritetit*”.

Fjalën e merr znj. McLaren, e cila ndërmjet një prezantimi në PPT u ndal konkretisht në këto pika; Cfarë është OGP (Open Government Partnership); Sesi Planet e Veprimit janë në thelb të pjesëmarrjes në OGP; Se kur jepen ide duhet të mbahen parasysh problemi, objektivit, zgjidhja dhe impakti; dhe se cdo ide e dhënë duhet të bazohet në kriteret specifike.

Kërkoi dhënien e komenteve, sugjerimeve dhe ideve të palëve të interesuar për këtë draft PV, pasi sic u shpreh këto komente do të bëhen pjesë e këtij PV ose të PV të radhës.

Fjalën e merr znj. Karapinjalli për të bërë një prezantim të shkurtër në PPT të draftit të Planit të Veprimit të OGP konkretisht të objektivit “Planet e Integritetit” si dhe për të ndarë me përfaqësuesit e shoqërisë civile “Matricën e Prioritizimit”. Theksi në këtë takim të katërt konsultativ u vendos tek fakti se këto takime kanë qënë të hapura, ka pasur llogaridhënie publike dhe cdo dokument tjetër strategjik është i publikuar në faqen e OGP. Theksoi gjithashtu se ka pasur një angazhim të madh të shoqërive civile, ku rreth 50 të tilla janë ftuar në takime, ku si pasojë roli i tyre në monitorimin e zbatueshmërisë së PV është shtuar. U tha se aktualisht MD po rishikon afatet kohore dhe kostot që janë ende në proces.

Znj. Pregja, ftoi të gjithë të pranishmit në trezë për të folur dhe diskutuar mbi draftin prezantuar. Kërkoi propozime konkrete dhe iniciativa që mund të vijnë nga OSHC për këtë dokument.

¹ <https://akshi.webex.com/akshi/j.php?MTID=m2333684872e7afd26a0a293cd0329fce>

Fjalën e merr znj. Rovena Sulstarova, përfaqësuese e IDM e cila në këtë takim të katërt konsultativ të draft-PV të OGP sugjeroi që drafti i PV të OGP për komponentin e IV “*Qeverisje e Hapur për Luftën kundër Korrupsionit*” të rishikohej, konkretisht duke propozuar; Sipas masës 2.2.1 nevojën për të pasur një P.I jo vetëm për MD por edhe për Ministrinë e Linjës; Nevojën për parashikim për miratimin e P.I; Renditjen e aktiviteteve, pasi në fillim duhet të jetë metodologjia e vlerësimit të riskut dhe më pas të tjerat; Sugjerimin që afati kohor për raportimin e brendshëm të monitorimit të zbatueshmërisë së P.I për 6M2 të 2021 të filloj në 6M1 të 2022; Dedikimin e P.I jo vetëm për ML por edhe për institucionet e varësisë; Një detajim më të plotë të P.I për ML; Përfshirjen e institucioneve të qeverisjes vendore në P.I; si dhe Rritjen e transparencës, paketave rregullatore të brendshme për sinjalizimet etj.

Në përfundim u theksua se propozimet/komentet/sugjerimet lidhur me përditësimin e masave/aktiviteteve nga ana e grupeve të interesit/OSHC si dhe përmbushjen e elementit të prioritizimit të dërgoheshin në rrugë elektronike sipas formatit të miratuar të formularit të vlerësimit.